



Konsultimi nënrajonat i OSHC-ve, aktivistëve të shoqërisë civile dhe ekspertëve gjinorë për Ballkanin Perëndimor¹ dhe Turqinë

Prill 2020

¹ Nga Ballkani Perëndimor, morën pjesë aktivistë dhe përfaqësues nga OSHC-të në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Serbi, së bashku me aktivistë dhe përfaqësues të OSHC-ve nga Turqia

Deklaratë e përbashkët e OSHC-ve, aktivistëve të shoqërisë civile dhe ekspertëve gjinorë pjesëmarrës në konsultimin nënrajonat për Ballkanin Perëndimor² dhe Turqinë

Ne, 42 aktivistë nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia paralajmërojmë qeveritë tona se **pandemia COVID-19 nuk është një shfaqje për të thelluar pabarazitë ekzistuese dhe si rrjedhojë për të mbyllur sytë përpara dhunës ndaj grave. Jemi shumë të shqetësuar për lirimin e mundshëm të autorëve të dhunës ndaj grave, siç propozohet në Turqi, dhe i bëjmë thirrje Qeverisë së Turqisë që të respektojë detyrimet e saj në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.**

- 1. Ne qëndrojmë të fortë e të bashkuar në solidaritet me njëri-tjetrin dhe me gratë dhe burrat që në zemrën e tyre kanë lirinë dhe mirëqenien e të gjithëve. Ne nuk do të lejojmë që kriza e COVID-19 të përdoret si një justifikim për rrënjosjen më të thellë të qeverisjes autoritare, shpenzime publike të papërgjegjshme dhe zgjidhje jo të efektshme të politikave që i përkeqësojnë problemet, në vend që t'i zbusin ato.**
- 2. Shtetet tona duhet të sigurojnë mbrojtjen e efektshme të grave dhe fëmijëve nga dhuna në familje, dhuna ekonomike dhe dhuna kibernetike ndaj grave, në bashkëpunim të ngushtë me grupet e grave, në të cilat gratë kanë besim dhe shërbejnë si rezervë burimesh për kompetencën gjinore në rajonin tonë. Shpesh, grupet e grave po zëvendësojnë qeveritë aty ku qeveritë e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë dështojnë. Tashmë ka ardhur koha që zyrtarët e qeverive të njohin gratë dhe grupet e grave si aleatë dhe partnerë për zhvillimin dhe ripërtëritjen e shoqërive tona, nëpërmjet politikave përkatëse që i hapin rrugë alokimit të baraspeshuar dhe konsistent të burimeve.**
- 3. Asnjë qeveri kombëtare dhe/ose vendore nuk mund të luftojë pandeminë e vetme. Luftimi i pandemisë në mënyrë të efektshme nënkupton luftimin nëpërmjet solidaritetit shoqëror. Vullnetarizmi dhe aktivizmi nuk duhet të paralizohen, të ndalohen apo të kontrollohen nga axhendat politike. Burimet publike duhet të jenë në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat e grave, për ofrimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të grave që i përkasin grupeve të cënueshme: gratë në zonat rurale, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara, gratë që i kanë mbijetuar dhunës në familje dhe nga partneri, LGBTI, nënat e vetme, refugjatet, dhe grupe të tjera të cënueshme. Ofruesit e shërbimeve nga sektori publik, jofitimprurës dhe privat duhet të mbrohen efektivisht nga përhapja e pandemisë, duke u bazuar në të njëjta protokolle dhe standarde. Sistemet tona janë të brishta dhe të cënueshme dhe ne duhet t'i mbrojmë ato dhe të kontribuojmë në zhvillimin dhe forcimin e tyre.**
- 4. Gratë po punojnë në vijën e parë dhe po luftojnë COVID-19 përkrah burrave. Ne i nxitim qeveritë tona që të njohin dhe të pranojnë kontributin e grave në luftën ndaj pandemisë si mjeke, infermiere, punonjëse shëndetësore, sanitare, gazetare, gra që punojnë në supermarkete etj. Pas orëve të zgjatura në punë, gratë e vijës së parë kthehen sërish në kujdesin, edukimin dhe punën e papaguar**

² Nga Ballkani Perëndimor, morën pjesë aktivistë dhe përfaqësues nga OSHC-të në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Serbi, së bashku me aktivistë dhe përfaqësues të OSHC-ve nga Turqia

në shtëpi, ndërsa qeveritë dhe media po humbasin mundësitë për të ndërgjegjësuar publikun se sa e padrejtë dhe e paqëndrueshme është kjo, si dhe për të inkurajuar një shpërndarje më të balancuar, të paanshme dhe të drejtë të punës së papaguar. Gjithashtu, masat e përkrahjes së familjes duhet të përshtaten për struktura të ndryshme të familjeve, duke përfshirë familje me një kryefamiljar, që në fakt shpesh janë gra dhe vajza.

5. **Për sipërmarrëset gra pasojat e kësaj krize do të jenë më të rënda dhe shumë më të ashpra në krahasim me sipërmarrësit burra, të cilët gjithashtu do të preken negativisht. Në nënrajonin tonë, gratë në sektorin privat janë të angazhuara kryesisht në sipërmarrje të vogla në sektorin e shërbimeve dhe në ekonominë informale. Ekziston një bazë të dhënash bindëse që nxjerrin në pah pa asnjë mëdyshje një ulje të menjëhershme dhe të dukshme të kërkesës për produkte dhe shërbime në sektorë ku mbizotërojnë gratë; shumë biznesmene dhe sipërmarrëse gra tani e kanë të vështirë që të përmbushin detyrimet e tyre, përfshirë taksat, kontributet shoqërore dhe shëndetësore; dhe po përballen me shpenzime shtesë si pasojë e krizës. Për më tepër, gratë kanë një barrë më të madhe të punës së papaguar që tashmë është shtuar për shkak të pandemisë, mbylljes së shkollave dhe mësimin online të fëmijëve. Duhet të vendosen masa ekonomike të përgjigjshme gjinore për të lehtësuar bizneset në pronësi të grave nga pasojat negative të pandemisë. Përndryshe, ne do të përballemi me një rritje të shkallës së varfërisë së grave dhe fëmijëve, një rritje të konsiderueshme të mbylljes së bizneseve në pronësi të grave, si dhe me shtimin e dhunës në familje dhe nga partneri, që në të njëjtën kohë do të rrisë varësinë ekonomike të grave.**
6. **Alokimet e burimeve të përgjigjshme gjinore duhet të integrohen në të gjitha shpenzimet publike, duke përdorur programin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor për të arritur rezultate pozitive si për prioritetet sektoriale dhe barazinë gjinore. Tani, më shumë se më parë, është e rëndësishme që qeveritë vendore dhe kombëtare të mbështetin forcimin e reziliencës së komunitetit nëpërmjet sistemeve hibride³ që mbulojnë të gjithë. Kjo nuk mund të arrihet pa të dhëna të përgjigjshme gjinore të disponueshme në mënyrë konsistente.**
7. **Nevojiten masa të veçanta që kombinojnë mbështetjen ekonomike me shërbimet sociale për gratë dhe fëmijët në përgjigje të nevojave të paplotësuara të grave të cënueshme që aktualisht po lihen mënjanë. Qindra mijëra gra që punojnë në ekonominë informale në nënrajonin tonë fitojnë më pak se burrat, kanë më pak siguri pune, më pak të drejta, dhe tani nuk kanë më as të ardhura. Deri më tani, asnjë qeveri në nënrajonin tonë nuk ka arritur të hartojë dhe zbatojë masa që t'i shërbejnë nevojave urgjente dhe afatgjata të këtij grupi të madh grash. Siguria dhe jetesa e tyre është një prioritet socio-ekonomik. Ndër të tjera, ky grup përfshin punëtore vendase dhe të huaja, punonjëse tekstilësh, gra në role mbështetëse në bujqësi, dhe gra emigrante që përballen veçanërisht me vështirësi të mëdha.**
8. **Gjithashtu, kërkohet vëmendja urgjente, mbrojtja, shërbimet dhe përkrahja e jetesës për gratë e moshuara dhe ato në zona rurale, të cilat janë ndër shtetasat më të privuara në nënrajonin tonë: në disa zona, nuk ka furnizim të rregullt me ujë dhe zbatimi i praktikës së higjienës është i vështirë për to, ndërkohë që marrin përsipër përgjegjësinë kryesore për të gjithë familjen. Nuk ka transport publik, nuk ka akses në kujdesin shëndetësor dhe shërbime, dhe as të ardhura nga tregjet e fruta-**

³ Një kombinim i aktorëve të sektorit publik, jofitimprurës dhe privat.

perimeve. Për to, **aksesi në internet** është i kufizuar siç është edhe **aksesi në informacion**. Kur **kufizohet lëvizshmëria**, shpesh janë burrat që lëvizin. Ka një **rritje të dhunës në familje**. **Gratë e moshuara dhe gratë me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione rezidenciale** janë **plotësisht të izoluar dhe nuk ka të dhëna publike** lidhur me statusin e tyre apo gjendjen shëndetësore. Në nënrajonin tonë, gratë dhe burrat e moshuar janë të diskriminuar dhe të privuar nga e drejta e tyre për të lëvizur lirisht dhe për të marrë vendime vetë. Me pretekstin e mbrojtjes dhe kujdesit, të moshuarit **janë burgosur brenda shtëpive të tyre pa shërbime mbështetëse të duhura** për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike dhe mendore.

9. Personat me aftësi të kufizuara (PAK), duke përfshirë **gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara**, kanë **më shumë rrezik që të preken nga COVID-19⁴**. Izolimi **prek PAK në mënyrë joproportionale** për shkak të **ndarjes nga kujdestarët** e tyre, nga personeli mbështetës dhe asistentët; për shkak të **përrjashtimit nga puna dhe arsimit** pasi mësimi në distancë dhe hapësirat online të punës mund të mos jenë të aksesueshme dhe mund të mos kenë pajisjet ndihmëse të përshtatshme; dhe për shkak të stigmës dhe diskriminimit kur personave më aftësi të kufizuar nuk i jepet përparësi për shërbime shëndetësore të disponueshme në mënyrë sistematike. **Gratë me aftësi të kufizuara përballen me pengesa në aksesin e programeve dhe shërbimeve të dhunës me bazë gjinore**, përfshirë **mungesën e informacionit në formate të aksesueshme; mungesë transporti** në strukturat shëndetësore dhe qendrat e grave; **pengesa mjedisore** në strukturat shëndetësore dhe qendrat e grave (p.sh. shkallë, nuk ka tualete të aksesueshme për karrige me rrota, etj.); dhe **qëndrimet negative** të pjesëtarëve të familjes, komuniteteve, madje dhe të personelit që ofron këto shërbime. Për **gra dhe burra me aftësi të kufizuara intelektuale**, edhe **informacioni më bazë nuk është i disponueshëm** në formate sa më të thjeshtë për përdoruesit. **Shërbimet e dhunës me bazë gjinore për gratë me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre gjatë pandemisë së COVID-19 duhet të rishikohen dhe të rimodelohen**. Organizatat e grave po përshtatin menaxhimin e rasteve duke përfshirë menaxhimin nëpërmjet telefonave celularë, komunikimit me WhatsApp dhe nëpërmjet video-konferencave.
10. **Përgjatë nënrajonit tonë, gratë zotërojnë më pak dhe punojnë më shumë se burrat**. Në mënyrë që të arrihet barazia gjinore në përputhje me detyrimet e ndërmarra në zbatim të konventave ndërkombëtare dhe legjislacioneve vendore (të cilat përbëjnë një kuadër ligjor të unifikuar), **qeveritë tona duhet të rrisin investimet në barazinë gjinore teksa po reagojnë ndaj COVID-19 dhe pasojave të tij**. Ne po paralajmërojmë qeveritë, shoqëritë tona dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit rreth pasojave negative imediate, afatmesme dhe afatgjatë të nëninvestimit në **shëndetin publik, arsimin, shërbimet sociale, infrastrukturën e lehtë dhe të rëndë që vendos qytetarët, gra dhe burra, vajza dhe djem, në qendër**. Kjo krizë na mëson që **nuk duhet të konsiderohet asnjë shkurtim në këta sektorë bazë**. Përkundrazi, përvoja aktuale botërore na tregon se **investimi publik më i madh në këta sektorë ku gratë përbëjnë boshtin e mirëqenies** për mbarë shoqëritë tona është një pjesë integrale e përgjigjes së ndërtimit të reziliencës.

⁴ Për shkak të: (a) pengesave për të aksesuar ambiente për larjen e duarve dhe për të larë duart; (b) vështirësi për të zbatuar distancimin social kur mbështeten te të tjerët për aktivitetet e tyre të përditshme; (c) nevoja për të prekur kur komunikojnë ose kur lëvizin përreth; (d) pengesa për të aksesuar informacionin publik rreth COVID-19; (e) personat me aftësi të kufizuara mund të kenë probleme shëndetësore që rrisin rrezikun e tyre për të zhvilluar komplikacione më të rënda nëse infektohen me COVID-19; (f) ata mund të përballen me pengesa shtesë për të aksesuar kujdesin e duhur shëndetësor për shkak të varësisë së tyre te të tjerët (kujdestarë dhe asistentë personalë), për të shkuar në strukturat shëndetësore; pengesa për të shprehur simptomat; pengesa fizike në strukturat shëndetësore.

11. Kjo është një mundësi për shoqëritë tona që të përfshijnë vajzat dhe djemtë e rinj si të barabartë dhe të sigurojnë që vendimmarrësit t'i dëgjojnë zërat e tyre. Të gjithë po përballen me diçka të re dhe nuk është e vërtetë që zgjidhjet tradicionale ofrojnë përgjigje të mira. Për të rinjtë, kjo nuk është vetëm për mbijetesë, por është për vetë-sakrifikimin dhe kujdesin e njerëzve të tyre të zemrës, dhe pasiguritë e mëdha që sjell e ardhmja përpos pengesave të akumuluarra për aksesin në punë, status social dhe për të kontribuar në vendimmarrje.
12. Ne kërkojmë mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë për një mekanizëm të efektshëm të solidaritetit feminist që do të na ndihmojë t'u përgjigjemi efektshëm përpjekjeve për të tkurrur hapësirën tonë, për të na hequr të drejtat tona dhe për të frenuar liritë e fituara me vështirësi në nënrajon. Ne duhet të mbështetemi te njëri-tjetri për të ndërtuar shoqëri të shëndosha dhe funksionale që vendosin mirëqenien e shtetasve të tyre, gra dhe burra, në krye.
13. Më tej ne kërkojmë mbështetjen ndërkombëtare për ngritjen e një Fondi Nënrajonal të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për Zgjidhje Novatore të Politikave që trajtojnë nevojat e vazhdueshme dhe të reja të grupeve të cënueshme, duke përfshirë ato që vijnë si rrjedhojë e emergjencave dhe pandemisë, sepse programi ynë i vjetër i masave jo gjithnjë përshtatet mirë ndaj realitetit të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave. Ky fond do të angazhojë aktorët e sektorit publik, jofitimprurës dhe privat në projektimin, pilotimin dhe zbatimin e zgjidhjeve novatore me qendër përdoruesin që mbështeten në pikat tona të forta të cilat në nënrajon nuk janë të pakta. Gjithashtu, ne duhet të shfrytëzojmë mundësinë që të gjejmë përgjigje më efikase në mënyrë që të jemi më të përgatitur, më të mbrojtur dhe në të përfshirë në reagimet e ardhshme.
14. Në rajonin tonë, mungesa e masave qeveritare për garantimin e aksesit të sigurt dhe në kohë të individëve në informacion, në të mira dhe në shërbime shëndetësore thelbësore seksuale dhe riprodhuese gjatë pandemisë është vërtet shqetësuese. Gratë dhe vajzat po përballen me kufizime të konsiderueshme në aksesin e sigurt të shërbimeve shëndetësore seksuale dhe riprodhuese, veçanërisht kujdesi në kohë të abortit, kujdesi pas abortit, dhe kontraceptivët. Këto kufizime prekin në mënyrë joproporcionale individët që i përkasin grupeve të marginalizuara, përfshirë gratë e shtresave të varfra, gratë me aftësi të kufizuar, gratë rome, gratë emigrante të padokumentuara, adoleshentet, dhe gratë në rrezik ose që i kanë mbijetuar dhunës seksuale dhe në familje. Për më tepër, këto kufizime krijojnë rreziqe të panevojshme të ekspozimit ndaj COVID-19 për gratë dhe vajzat, familjet e tyre, si dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor⁵.
15. Ne i kërkojmë medias që të përfshijë në dialogun rreth së ardhmes së nënrajonit tonë gratë nga profesione, mosha, përkatësi etnike, orientim seksual, identitet gjinor, gjendje shëndetësore, aftësi të kufizuar, status civil, status emigranti apo refugjati, apo çfarëdo statusi apo përvoja të tjera të ndryshme. Vizibiliteti i grave dhe përforsimi i zërave të tyre të shumëllojshëm, duke përfshirë dhe zërat feminist, është një punë thelbësore e medias në një shoqëri demokratike. Shumëllojshmëria e dallimeve, përvojave, nevojave dhe ideve e bën Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë një nënrajon unik dhe të pasur që duhet të kërkojë përgjigje në bashkëpunimin dhe mësimin e ndërsjellë.

⁵ <https://www.hrw.org/news/2020/04/08/joint-civil-society-statement-european-governments-must-ensure-safe-and-timely>